

KONTRATË SHITJE

PËR KUOTA Pjesëmarrje në Kapital E.C.D.S GROUP Sh.P.K.

Sot, më datë 14/07/2024 në zyrat e selisë së shoqërisë "E.C.D.S GROUP" Sh.PK. lidhet kjo kontratë shitje kuotash pjesëmarrje në kapitalin e të njëjtës shoqëri, me palë dhe kushte si më poshtë vijon:

1) Z. Sokol Durma, i datëlindjes 06/03/1985, shtetas shqiptar me dokument identifikimi Nr. I50306057F, i moshës madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i mëposhtëshënuar për lehtësi në vijim si "Shitesi" ;

2) Z. Oltion Marko, i datëlindjes 03/04/1978 , shtetas shqiptar me dokument identifikimi Nr.H80403044K, i moshës madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i mëposhtëshënuar për lehtësi në vijim si "Bleresi"

3) Z. Neritan Shkodrani, i datëlindjes 17/02/1965 , shtetas shqiptar me dokument identifikimi Nr.G50217039L, i moshës madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i mëposhtëshënuar për lehtësi në vijim si "Bleresi"

Në vijim, gjithashtu, si "Shitesi" ashtu edhe "Bleresit do të përshkruhen edhe si "Palët" .

Meqenëse:

a) Shitesi, deklaron se është ortak zotërues i 1 (një) kuote pjesëmarrje përfaqësuese të 100% (njëqind përqind) me një vlerë prej 100.000.00 (një qind mijë) lekë të kapitalit të shoqërisë "E.C.D.S" Sh.PK, një shoqëri e themeluar dhe me veprimtari në përputhje me legjislacionin shqiptar, me seli në Tiranë, regjistruar më datë 11/03/2024 në Regjistrin Tregtar Shqiptar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit M41511015U;

b) Shitesi dëshiron t'i shesë blerësve kuotën e zotëruar prej tij në shoqërinë e sipërpërmendur, që korrespondon me 66% (gjishtëdhjetë e gjashtë përqind) të kapitalit të shoqërisë me vlere 66.000 leke; perkatesisht 33 % Z. Oltion Marko me vlere 33.000 leke, dhe 33 % Z. Neritan Shkodrani me vlere 33.000 leke.

c) Bleresit pranojnë të blejnë kuotat me cmimin e rene dakort si me sipër dhe të behen ortakë të shoqërisë me të gjitha të drejtat që i takojnë.

Sa më sipër, Palët e mësipërme bien dakord të lidhin këtë Kontratë, sipas kushteve në vijim:

Neni 1

Objekti i Kontratës

1.1 Sipas kushteve dhe parashikimeve të kësaj Kontrate, Shitesi transferon permes shitjes, duke kaluar në emër të secilit prej Bleresve 33% të kuotës së kapitalit të zotëruar prej tij, që në total përfaqëson 66% të kapitalit të tij tek Bleresit.

1.2 Secili nga Bleresit bëhet zotërues me të drejta të plota të 33% të kapitalit të shoqërisë (në vijim "pjesa e kapitalit të shitur"), pas nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe nga ky moment Shoqëria behet me tre ortakë:

Ortaku Z. Sokol Durma zotëruesi i 1 (një) kuote me vlere te përgjithshme 34.000 leke ne para qe përben edhe 34% te kapitalit themeltar te shoqërisë.

b. Ortaku Z. Oltion Marku, zotëruesi i 1 (një) kuote me vlere te përgjithshme 33.000 leke ne para qe përben edhe 33 % te kapitalit themeltar te shoqërisë.

c. Ortaku Z. Neritan Shkodrani, zotëruesi i 1 (një) kuote me vlere te përgjithshme 33.000 leke ne para qe përben edhe 33 % te kapitalit themeltar te shoqërisë

1.3 Palët bien dakord që pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, Bleresit do të ushtrojnë të gjitha të drejtat që lidhen dhe rrjedhin nga pronësia mbi pjesën e kapitalit të shitur nga Shitesi.

Neni 2

Tatimet dhe shpenzimet

2.1 Palët do të përballojnë kostot dhe shpenzimet e tyre përkatëse qe kanë kryer në lidhje me negociimin, nënshkrimin dhe dorëzimin e kësaj Kontrate.

Neni 3

Deklarime dhe Garanci

3.1 Shitesi deklaron dhe garanton për Bleresit sa vijon:

a) Shoqëria në fjalë është themeluar dhe e regjistruar rregullisht në Regjistrin Tregtar dhe ushtron aktivitetin e saj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe statutin e shoqërisë;

b) Ka të gjithë aftësitë juridike për të nënshkruar këtë Kontratë dhe se nuk ka asnjë pengesë ligjore që do të cënonte aftësinë e tij për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë dhe se kjo Kontratë përben një detyrim të vlefshëm të Shitesit të zbatueshëm në përputhje me dispozitat e saj;

c) Shitesi është pronar i ligjshëm i kuotës të kapitalit të shoqërisë dhe ka titull të plotë pronësie si dhe zotëron të gjithë interesin e përfitimit kundrejt kësaj kuote kapitali;

d) Shitesi zotëron pjesën e kapitalit të dhuruar të lirë nga çdo peng, barrë siguroese, pengesë, pretendime të të tretëve, kufizime, si dhe çdo masë tjetër sigurie apo ligjore. Gjithashtu nuk ekziston asnjë garanci, e drejtë zgjedhjeje, kontratë shitjeje kuotash, kontratë ri-blerjeje, kufizim i çfarëdo natyre, të çfarëdo lloji qofshin, në lidhje me pjesën e kapitalit të dhuruar;

e) Kapitali i Shoqërisë është shlyer rregullisht nga ortaku dhe nuk ka asnjë detyrim të papërmbushur dhe/ose të shkelur nga ortaku në lidhje me shlyerjen e kapitalit;

f) Shitesi zotëron pjesët e kapitalit të dhuruar për llogari dhe në emrin e tij si dhe nuk ekziston asnjë "ortak i fshehtë" ose detyrim tjetër përta i përket ndarjes së fitimit;

g) Shoqëria nuk është në proces falimenti ose likuidimi;

h) Shitesi garanton se nuk ka asnjë dijeni për ndonjë fakt apo çështje, fshehja e të cilave bën që secila prej këtyre deklaratave dhe garancive të jetë çorientuese apo që do të apo që mund të ndikojë gjykimin e Bleresve në lidhje me blerjen e pjesës të kapitalit.

3.2 Bleresit me anë të kësaj Kontrate deklarojne dhe garantojne Shitesin se:

a) Kane të gjithë aftësitë juridike për të nënshkruar këtë Kontratë dhe se nuk ka asnjë pengesë ligjore që do të cënonte aftësinë e tyre për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga

kjo Kontratë dhe se kjo Kontratë përbën një detyrim të vlefshëm të Bleresve të zbatueshëm në përputhje me dispozitat e saj;

b) Përbush të gjitha kriteret për të ushtruar veprimtarinë e parashikuar në Statutin e shoqërisë ;

c) Nuk ka asnjë fakt, rrethanë apo informacion i cili mund të çënojë në çfarëdo mënyrë aftësinë e tij për të ushtruar të drejtat dhe zbatuar detyrimet nga zotërimi i pjesës së kapitalit të dhuruar.

d) Kane paguar vlerën e aksioneve të përcaktuara në kontratë në momentin e lidhjes së kësaj Kontrate.

Neni 4

Pranimi

4.1 Për të shmangur çdo paqartësi dhe/ose dyshim, Bleresit pranojnë pjesët e kapitalit si dhe sa më sipër në përputhje me kushtet dhe kufizimet e parashikuara në këtë Kontratë si dhe në Statutin e shoqërisë.

Neni 5

Të ndryshme

5.1 Garanci të tjera.

Palët bien dakord që të ndërmarrin ato veprime të tjera të cilat nuk parashikohen shprehimisht në këtë Kontratë, siç mund të rezultojë eventualisht e nevojshme apo e dëshirueshme për realizimin e shitjes së pjesëve të kapitalit sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë.

Palët bien dakord që të ndërmarrin këto veprime të tjera siç mund të jetë e nevojshme apo e dëshirueshme dhe pranojnë në mirëbesim të kryejnë këto procedura eventuale siç mund të jetë e nevojshme për realizimin e shitjes së pjesëve të kapitalit, në përputhje me të gjitha ligjet, rregullat dhe/ose rregulloret që bëhen të zbatueshme; me kusht, gjithsesi, që asnjërës Palë të mos i kërkohet që të ndërmarrë ndonjë prej këtyre veprimeve apo të respektojë këto procedura eventuale shtesë në rast se të njëjtat do t'i shkaktonin një barrë të rëndë apo kosto dhe shpenzime të papërbalueshme.

5.2 Forca Madhore.

Asnjëra Palë nuk do të jetë përgjegjëse për mospërbushjen e detyrimeve të saj përkatëse sipas kësaj Kontrate në rast Force Madhore.

Për qëllimet e kësaj Kontrate, Forca Madhore do të nënkuptojë një ngjarje e cila nuk mund të parashikohet apo mënjanohet dhe që shkon përtej kontrollit të palëve duke e bërë të objektivisht të pamundur përmbushjen e çfarëdo detyrimi që rrjedh nga kjo Kontratë.

5.3 Marrëveshja.

Kjo Kontratë përbën të gjithë Marrëveshjen dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet dhe rregullimet e mëparshme, verbale dhe/ose të shkruara, ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

5.4 Transferimi.

Asnjëra Palë nuk do të ketë të drejtë të japë apo transferojë të gjitha apo cilëndo prej të drejtave të saj, përfitimeve apo detyrimeve sipas kësaj Kontrate, pa miratimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

5.5 Efektet detyruese.

Kjo Kontratë do të ketë fuqi detyruese për Palët.

5.6 Veçueshmëria:

Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate konsiderohet e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme, ajo do të modifikohet në minimumin e nevojshëm për ta kthyer në të vlefshme, të ligjshme dhe të zbatueshme, ose, nëse një modifikim i tillë nuk është i mundur, kjo dispozitë do të mënjanohet nga kjo Kontratë dhe dispozitat e tjera të kësaj Kontrate do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi dhe të vlefshme.

5.7

Kjo Kontratë dhe të gjitha kushtet e parashikuara në të do të rregullohen, interpretohen dhe do të jenë të zbatueshme në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

5.8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.

Palët do të përpiqen që të zgjidhin miqësisht çdo konflikt, ndryshim, mosmarrëveshje apo pretendim i çfarëdo lloji, sido që të ketë lindur, nga apo në lidhje me këtë Kontratë, përfshirë çdo pyetje që i përket mospërmbushjes, ekzistencës, vlefshmërisë apo zgjidhjes së kësaj Kontrate të cilat Në rast se Palët nuk arrijnë një marrëveshje miqësore mbi sa më sipër atëherë do t'i drejtohen për zgjidhje të fundme, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane .

5.9 Gjuha dhe kopjet.

Kjo Kontratë përpilohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale

5.10 Hyrja ne fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të tre Palët.

Palët, pasi lexuan Kontratën e Shitjes, deklarojnë se e kuptuan dhe bien dakord me të si në tërësi ashtu edhe në veçanti me kushtet e saj ndaj nënshkruajnë si vijon:

Shitesi:

Bleresi:

Bleresi:

SOLCOL DURMA

Emër, mbiemër, firmë

10/24

Olivia Masha

Emër, mbiemër, firmë

Anton Shkodran

Emër, mbiemër, firmë